

**Formular për SYLLABUS të Lëndës Radiologji ( sem VI)**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Radiologji</b>
<b>Niveli:</b>	Mjekësi Veterinare
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti III, sem VI</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1(30/15)</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>4</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Instituti i Blegtorisë dhe Veterinarisë
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Avni Robaj</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë e-mail: avni.robaj@uni-pr.edu tel: +383 44 141 925
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Fizika e rrezatimit. Tubi i rrezeve x. Aparati radiografik. Filmrat radiografikë, kasetat, skermot përforcues. Zhvillimi i filmit. Salla e rrezatimit dhe dhoma e errët. Parimet e mbrojtjes nga rrezet. Metodika, teknikat dhe projeksionet radiologjike. Fizika dhe gjeometria e imazheve radiografike. Terminologjia për pozicionimin radiografik të pacientit. Metodika e egzaminimit radiologjik, anatomia radiologjike normale dhe patologjike e sistemeve dhe aparateve: Koka, toraksi, abdomeni, aparati tretës, aparati gjeneral dhe urinar, kolona vertebrale, pelvisi, gjymtyra e përparme, gjymtyra e pasme. Egzaminimi radiologjik në pozicione të detyruara. Egzaminimi radiografik me tufë rrezesh horizontale. Kontrasti radiografik. Teknika radiografike speciale. Ezofagografia. Gastrografia. Ileografia. Kolonografia. Urografia. Cistografia. Uretrografia. Mielografia. Epidurografia. Diskografia. Artrografia. Bronkografia. Pleurografia. Peritoneografia. Angiografia. Fistulografia. Ekografia dhe Ekotomografia. Scintinografia. Tomografia e kompjuterizuar. Rezonanca magnetike nukleare. Endoskopia dhe videoskopia.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Njohja e studentëve me bazat teorike dhe praktike të radiografisë, tomografisë, scintigrafisë, ekografisë, etj. Nëpërmjet këtyre teknikave studenti duhet të perfeksionojë metodat e ndryshme të imazheve me qëllim interpretimin dhe vendosjen e diagnozës në situata të ndryshme patologjike. Pjesa praktike e programit, përfshin temat kryesore të nevojshme për aftësimin e përgjithshëm praktik të studentëve në disiplinën e Radiologjisë. Në këtë program janë parashikuar ushtrime që do të realizohen kryesisht në kafshë të vogla si element i ri që bën të mundur

	aktivizimin e të gjithë studentëve.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Studentët pas mbarimit të kësaj lënde do të jenë në gjendje përmes ligjëratave dhe ushtrimeve praktike të dijnë të vlersojnë grafitë e ndryshme në kafshë të ndryshme, të perfeksionojë metodat e ndryshme të imazheve me qëllim interpretimin dhe vendosjen e diagnozës në situata të ndryshme patologjike.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime praktike (demonstrim klinik-praktik)	1	1/15	15
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	1/10	10
Projekte, prezantime, seminare.	1	3/-	3
Koha e studimit vetanak	1	1/5	5
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1/15	30
Kolokiume	2	2/-	4
Testi final	1	3/-	3
<b>Totali</b>			<b>100</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Mësimdhënia në lëndën Radiologji Veterinare realizohet përmes ligjëratave teorike, seminareve interaktive dhe ushtrimeve praktike. Ligjëratat ofrojnë njohuri bazë mbi parimet e radiologjisë veterinarë, përfshirë bazat e diagnostikimit me imazheri, përdorimin e rrezeve X, si dhe parimet e sigurisë radiologjike. Gjithashtu trajtohen indikacionet dhe aplikimi i metodave të ndryshme të diagnostikimit me imazheri në specie të ndryshme të kafshëve. Seminarët fokusohen në analizimin dhe interpretimin e imazheve radiologjike, diskutimin e rasteve klinike dhe përdorimin e metodave diagnostike për identifikimin e patologjive të ndryshme. Pjesa praktike zhvillohet në ambiente klinike dhe laboratorike, ku studentët angazhohen në demonstrime dhe ushtrime praktike për realizimin e ekzaminimeve radiologjike dhe interpretimin e imazheve diagnostike nën mbikëqyrje profesionale. Mjetet e mësimdhënies përfshijnë prezantime PowerPoint, projektor multimedial, materiale audio-vizuale, demonstrime klinike, si dhe përdorimin e pajisjeve radiologjike dhe programeve kompjuterike për analizën e imazheve diagnostike.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i studentëve në lëndën e Radiologjisë realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe përmbyllëse, sipas		

	<p>strukturës në vijim:  15% - Kolokiumi i parë me shkrim, i organizuar gjatë zhvillimit të ligjëratave  15% - Kolokiumi i dytë me shkrim, i organizuar gjatë zhvillimit të ligjëratave  10% - Vlerësimi i vijueshmërisë dhe angazhimit gjatë semestrit  60% - Testi përfundimtar  Sistemi i notimit (6-10)</p> <p>Nota përfundimtare përcaktohet në bazë të përqindjes totale të pikëve të fituara gjatë semestrit dhe në provimin përfundimtar. Vlerësimi realizohet sipas kësaj shkalle:</p> <p>Studentët që arrijnë 50-59% të pikëve totale vlerësohen me notën 6,  Studentët që arrijnë 60-69% të pikëve totale vlerësohen me notën 7,  Studentët që arrijnë 70-79% të pikëve totale vlerësohen me notën 8,  Studentët që arrijnë 80-89% të pikëve totale vlerësohen me notën 9,  Studentët që arrijnë 90-100% të pikëve totale vlerësohen me notën 10.  Nota 5 konsiderohet notë jokaluese.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p>Barr, F., &amp; Lorrie, G. <i>Canine and Feline Radiology</i>. 2011.</p> <p>Daniel, G. B. <i>Basic Principles of Radiology</i>. 2001.</p> <p>Hecht, S. (Ed.). <i>Diagnostic Radiology in Small Animal Practice</i> (2nd Edition). 5m Books, 2020.</p> <p>Mai, W., &amp; Schweizer-Gorgas, D. (Eds.). <i>Diagnostic MRI in Dogs and Cats</i> (2nd Edition). Routledge, 2026.</p> <p>Shabani, E., &amp; Robaj, A. <i>Radiologjia Veterinare</i>. 2016.</p> <p>Thrall, D. E. (Ed.). <i>Textbook of Veterinary Diagnostic Radiology</i> (8th Edition). Saunders, 2024.</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Hecht, S. (Ed.). <i>Diagnostic Radiology in Small Animal Practice</i> (2nd Edition). 5m Books, 2020.</p> <p>Mai, W., &amp; Schweizer-Gorgas, D. (Eds.). <i>Diagnostic MRI in Dogs and Cats</i> (2nd Edition). Routledge, 2026.</p> <p>Thrall, D. E. (Ed.). <i>Textbook of Veterinary Diagnostic</i></p>

	Radiology (8th Edition). Saunders, 2024.
--	--

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Diagnozat radiologjike
<i>Java e dytë:</i>	Parimet fizikale të diagnozës radiologjike
<i>Java e tretë:</i>	Radiografia digjitale
<i>Java e katërt:</i>	Teknikat dhe metodat radiologjike
<i>Java e pestë:</i>	Ndertimi i aparatit te rrezeve X
<i>Java e gjashtë:</i>	Filmi radiografik, gridat, ekranet dhe kasetat
<i>Java e shtatë:</i>	Diagramat teknike, <b>Kolokium I</b>
<i>Java e tetë:</i>	Radiobiologjia, mbrojtja nga rrezatimi
<i>Java e nëntë:</i>	Radiologjia speciale, principet e pergjithshme të pozicionimit
<i>Java e dhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve respiratore
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve te sistemit kardiovaskular
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve te aparatit tretes
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve te kockave
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve urogjenitale. Ultrasonografia dhe endoskopia
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Kolokium II</b>
<b>Java</b>	<b>Ushtrimet që do të zhvillohen</b>
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i modulit, objektivat, kërkesat, procedurat, etj
<i>Java e dytë:</i>	Parimet e teknikave radiografike, prodhimi i rrezeve X.
<i>Java e tretë:</i>	Ekzaminimi me anë të teknikave digjitale radiografike
<i>Java e katërt:</i>	Teknikat dhe metodat radiologjike
<i>Java e pestë:</i>	Ndertimi i aparatit te rrezeve X, Filmi radiografik, ekranet dhe kasetat
<i>Java e gjashtë:</i>	Kolokium I
<i>Java e shtatë:</i>	Diagramat teknike
<i>Java e tetë:</i>	Radiobiologjia. Mbrojtja nga rrezatimi
<i>Java e nëntë:</i>	Radiologjia special, principet e pergjithshme të pozicionimit
<i>Java e dhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve respiratore
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve te sistemit kardiovaskular
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve te aparatit tretes
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve te kockave
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Diagnoza imazherike e semundjeve urogjenitale. Ultrasonografia dhe endoskopia
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kolokium II